

MUIN ÇAMI**FIGURA E BAJRAM CURRIT NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE***

Personalitetet apo figurat hyjnë në histori dhe renditen në faqet e saj, sipas rolit, pozitiv apo negativ, që kanë luajtur për të ardhmen e një vendi, të një kombi, apo edhe më gjerë. Ka figura që përmenden dhe vlerësohen në histori për rolin e tyre negativ, të tjerë për rolin e tyre pozitiv, si luftëtarë të vendosur në fushën e mbrojtjes së të drejtave politike dhe të zhvillimeve ekonomike e shoqërore. Ndër këta të fundit një vend të veçantë dhe të nderuar zë Bajram Curri. E në çfarë veprimtarie nuk e gjen të pasqyruar figurën e Bajram Currit, në historiografinë e të dy pjesëve të kombit shqiptar, të ndarë politikisht më 1913.

E kaluara historike e ka renditur Bajram Currin, për veprimtarinë e tij në të mirë të kombit shqiptar, në piedestalin e Heronjve të Popullit. Për nder të tij, një qendre të banuar në veri të Shqipërisë, në vitet 60 të shekullit të kaluar (të shek. XX), i është vënë një emër i ri, ai i Bacë Bajramit. Është i vetmi rast në historinë e Shqipërisë që një qytet të jetë i pagëzuar me emrin e një figure historike me origjinë shqiptare. Po në këtë qytet, në Bajram Curr, është vendosur në vitin 1982 dhe qëndron gjithmonë lart edhe përmendorja (shtatorja) e Bajram Currit. Portreti i tij zë po ashtu një vend qendror në Muzeun Historik në Tiranë, krahas portreteve të Fan Nolit, Avni Rustemit, Luigj Gurakuqit etj.

Me ndryshimet e thella politike dhe ekonomike-shoqërore që ndodhën në Shqipëri në fund të viteve 90 të shekullit që sapo mbaroi, pati raste përmbysjeje përmendoresh (si, për shembull ai i Enver Hoxhës dhe i disa të tjerëve), si dhe kthim në origjinë i emrit të ndonjë qyteti, si ai i

* Trajtesë e lexuar në simpoziumin e organizuar nga Instituti i Historisë i Prishtinës në bashkëpunim me Institutin e Historisë së Tiranës, me rastin e 80-vjetorit të rënies së Bajram Currit, Gjakovë, 8 korrik 2005.

Kuçovës, për shembull. Ndërsa emri i qytetit Bajram Curri dhe përmendorja e tij nuk u cenuan. A nuk janë këto raste ndër dëshmitë më të prekshme të respektit që gëzon figura historike e Bajram Currit në opinionin e gjerë publik shqiptar?

Pas kësaj paraqitjeje të përgjithshme, na duhet të shtojmë se mjaft mjedise të vendit janë zbukuruar me portrete, me buste dhe piktura kushtuar Bajram Currit. Sidomos me dhjetëra janë veprat e artit të vendosura në Galerinë e Arteve në Tiranë. Po ashtu, mjaft institucione arsimore dhe kulturore në Shqipëri mbajnë emrin e nderuar të Bajram Currit. Me sa jemi në dijeni, këto emërtime janë përhapur edhe në Kosovë, çfarë është krejt e natyrshme. Do shtuar gjithashtu se në raftet e bibliotekave tona publike, por edhe në ato vetjake, qëndrojnë të radhitura botime të letërsisë artistike që kanë në qendër të tyre trajtimin e figurës së B. Currit, si romane historike etj.

Po ç'mund të themi për pasqyrimin dhe vlerësimin e figurës së B. Currit në historiografinë shqiptare, që e veçuem si çështje për ta kumtuar në këtë tubim, të organizuar me rastin e vitit jubilar të 80-vjetorit të rënies së Heroit? Nga vëzhgimet e posaçme që bëmë me këtë rast duke shfletuar botimet e historisë kombëtare, më rezultoi se veprimtaria e B. Currit është pasqyruar gjerësisht në këto botime dhe në të gjitha periudhat historike, në të cilat ai ka vepruar. Veprimtaria e tij shtrihet përgjatë një çerek shekulli, që nga fundi i shek. XIX, nga koha e Lidhjes së Pejës dhe deri sa zemra e tij pushoi së rrahuri, në mars të vitit 1925.

B. Curri është pasqyruar nga historianët tanë si një nga figurat qendrore të Lëvizjes Kombëtare të kësaj periudhe historike, veçanërisht të periudhës që nga pragu i shpalljes së Pavarësisë e këndeje. Këtë vlerësim e gjejmë jo vetëm në botimet akademike dhe universitare, por deri edhe në tekstet e historisë për shkollat e mesme. Madje e gjen edhe në librat e shkollave fillore. Dhe gati të gjitha shkrimet e teksteve shkollore janë shoqëruar me portrete të B. Currit.

Me raste përvjetorësh të rrumbullakët të jetës së B. Currit janë organizuar, nga institute të specializuara, sesione shkencore e përkujtimore, siç është rasti i simpoziumit të sotëm. Shkrimet e lexuara në raste të tilla, janë përmbledhur në botime të veçanta, që kanë shërbyer për njohjen më të gjerë të veprimtarisë së heroit tonë. Me dhjetëra janë autorët që kanë shkruar për episode nga jeta e B. Currit. Duhet thënë ndërkaq se deri sot nuk është botuar ndonjë monografi e veçantë dhe e plotë për B. Currit, sikurse janë botuar për bashkëpunëtorët e tij, për

shembull për Ismail Qemalin, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, për Hoxha Kadriun dhe të tjerë. Nuk është botuar një studim i tillë as në shtetin amë dhe as në Kosovë apo gjetkë. Burimi i kësaj mungese na duket se rrjedh nga pamjaftueshmëria e dokumenteve ose materialeve të tjera, të hartuara nga vetë B. Curri dhe që të mbajnë firmën e tij. Por, pavarësisht nga këto rrethana, na duket një boshllëk që duhet pasur parasysh për ta plotësuar në të ardhmen.

Për sa i përket veprimtarisë politike të B. Currit, kjo është pasqyruar, siç pohuam, në botimet me përmbajtje historike, që kur ai u shqua si luftëtar i çështjes kombëtare dhe për gjatë një çerekshekulli. Ajo që spikat në të gjitha shkrimet është cilësimi i tij si *patriot i madh*, që jetën ia kushtoi mbrojtjes së të drejtave kombëtare të popullit të vet, sidomos pas vitit 1913, kur të gjashtë Fuqitë e Mëdha evropiane të kohës e ndanë popullin shqiptar politikisht në dy pjesë.

Në shkrimet historike B. Curri është vlerësuar, pra, gjithandej dhe me të drejtë si patriot i madh dhe si një prijës popullor i kryengritjeve çlirimtare kundër pushtuesve të ndryshëm. Në fillim kundër pushtuesve osmanë, mandej, me aneksimin e Kosovës nga qeveria serbe e Beogradit, nuk reshti së luftuari, së toku me bashkëpunëtorët e tij, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar, në përgjithësi, dhe ato të popullsisë shqiptare të Kosovës në veçanti.

Ndërkaq, ndarja e popullit shqiptar në dy pjesë, krijoi probleme të reja për udhëheqësit e këtij populli, për bashkërendimin e veprimeve të tyre në të dyja anët e kufirit, në të mirë të çështjes mbarëkombëtare. Ky bashkëveprim apo bashkëpunim nisi që në nëntor-dhjetor 1912, me formimin e Qeverisë së parë Kombëtare të Ismail Qemalit, në përbërjen e së cilës u përfshinë edhe udhëheqës nga Kosova si Mehmet pashë Dëralla. Bashkëpunimi vijoi në vitin 1913 me organizimin e kryengritjes së shtatorit të atij vitit ... e zhvilluar në trojet shqiptare të sapa shkëputura nga trungu amë dhe të aneksuara nga mbretëria serbe e Karagjeorgjeviçëve. Pika kulmore e këtij bashkëveprimi u regjistrua në vitin 1920 me kontributin që dha Komiteti i "Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës", në thirrjen dhe mbajtjen me sukses të Kongresit të Lushnjes dhe me pjesëmarrjen në qeverinë që doli nga ky kongres, të Hoxha Kadri Prishtinës dhe mandej të Bajram Currit. Që të dy, veçanërisht B. Curri, si anëtar qeverie dhe si komandant i forcave ushtarake, dha një kontribut me peshë në arritjet që pasuan menjëherë Kongresin e Lushnjes, të janarit 1920.

Kongresi i Lushnjës shënoi, sikurse dihet, një pikë kthese në jetën e Shqipërisë. Më 1920-ën u rifitua pavarësia kombëtare e shtetit shqiptar dhe u mënjanua një copëtim i ri i trojeve shqiptare. U zgjidh kështu problemi nacional për atë pjesë të popullit shqiptar që u përfshi brenda kufijve politikë të vitit 1913, por jo për gjysmën tjetër që u la jashtë kufijve, si popullsia e Kosovës etj.

Bajram Curri qëndroi dhe punoi në Shqipëri edhe pas vitit 1920, së bashku me disa prijës të tjerë kosovarë. Dhe punoi njëherazi për Kosovën dhe për Shqipërinë. Në ngjarjet politike që ndodhën në shtetin amë në vitet 1921-1924, Bajram Curri mori pjesë aktive duke u radhitur gradualisht, siç dihet tanimë, në krah të forcave demokratike, duke luajtur një rol të rëndësishëm në fitoren që këto forca, të udhëhequra nga Fan Noli, arritën në qershor të vitit 1924. Ky rol i B. Currit është pasqyruar gjerësisht në botime historike kolektive ose në shkrime të autorëve të ndryshëm. Në këto të fundit janë shprehur ndërkaq edhe mendime që zor se i qëndrojnë kritikës shkencore.

Për shembull, në mjaft shkrime, madje edhe të autorëve me përvojë, radhitja e B. Currit në anën e forcave demokratike shpjegohet me shumë me pikëpamjet e tij ekonomike e shoqërore antifeudale dhe jo me faktin se kjo radhitje i shërbente më mirë luftës së tij për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Bajram Currit i janë veshur madje ide edhe më të majta se kaq¹. Mendime të tilla na duket se hyjnë në kuadrin e politizimeve të kohës së kaluar. Për B. Currit dhe për popullsinë shqiptare të Kosovës, problemi parësor vijonte të ishte ai politik nacional dhe jo ekonomik-shoqëror. Sidoqoftë këto janë pohime që nuk e zbehin paraqitjen e vlerave të vërteta të B. Currit në historiografi.

Në mbyllje na duket me interes të pohojmë se pjesëmarrja e B. Currit dhe e disa udhëheqësve të tjerë kosovarë në lëvizjen demokratike të viteve 1921-1924, si H. Prishtina, Hoxha Kadriu etj., dëshmon se në këtë lëvizje bashkëjetonte, me peshën e tij të rëndë edhe problemi kombëtar, çka përbën një veçori në zhvillimin e lëvizjes demokratike të viteve 1921-1924 të vendit tonë.

¹ Në këtë drejtim është dalluar më shumë prof. Ali Hadri. Shih: A. Hadri, *Bajram Curri – demokrat përparimtar*, në “Bajram Curri”, (trajtesa e dokumente), Tiranë, 1982, f.32-36.